



I NË VEND TË HYRJES...

Për herë të parë e "takova" *Graalin* në skenat e filmit të regjisorit Steven Spielberg, "Indiana Jones dhe Kryqëzata e Fundit" (1989) në të cilin rrëfëhet se si arkeologu aventurier Indiana Jones, pothuajse pa dëshirën e tij, detyrohet të vihet në kërkim të objektit të mistershëm të quajtur "*Graal*" dhe papritmas zbulon se në kërkim të tij, ishin vënë edhe nazistët e Rajhut të Tretë. Nëse vetitë legjendare të *Graalit* do të ishin të vërteta dhe jo thjesht, pjellë e fantazisë njerëzore, nazistët do të mund ta përdornin forcën e tij për të shtrirë pushtetin e tyre mbi mbarë botën, por Indiana Jones nuk mund të lejonte, që bota të sundohej nga forcat e errësirës (nazistët!). Së fundmi pas një sërë aventurash dhe skenash që të linin pa frymë, arkeologu amerikan, do të bënte që plani i nazistëve për të shtënë në dorë *Graalin* e aq dëshiruar, të dështonte, duke shpëtuar kështu mbarë botën nga sundimi nazist. Të entuziazmuar nga filmi, në mënyrë thuajse të pandërgjegjshme, unë dhe shoku im më i ngushtë me të cilin kishim ndarë gjatë fëmijërisë dhe rinisë sonë të hershme (që shumëkush e quan adoleshencë!) aq trishtime dhe gëzime, vendosëm që të "niseshim" në kërkim të *Graalit*.

Çfarë ishte ai?

Gjëja e parë që na erdhi në mendje për të zbuluar përgjigjen e kësaj pyetjeje ishte shfletimi i një botimi të vjetër të fjalorit enciklopedik francez "Petit Larousse" (1967), dhe në faqen numër 1934 ("në të njëjtin vit në të cilin zhvilloheshin edhe ngjarjet e filmit!", do të vërente shoku im me një pamje komplotisti të stampuar mbi fytyrë!)...

Eureka!

Gjetëm shpjegimin që kërkonim...

Apo më saktë vetëm pak më shumë, nga ajo që ndërkohe dinim!

Fjalori e përshkruante *Graalin* si një gotë prej smeraldi me të cilën kishte pirë Krishti në darkën e fundit, ku një farë Josifi nga Arimatea kishte mbledhur më pas gjakun, që rrodhi nga plaga e Krishtit në kryq, që centurioni romak Longino i kishte shkaktuar me heshtën e tij. Më pas enciklopedia shpjegonte, përciptazi se ishin të shumta romanet të cilat përshkruanin historinë e kërkimit të *Graalit* nga kalorësit e mbretit Artur.



Është thujse e kotë të them se shpjegimi i fjalorit na zhgënjë!

Edhe në film, *Graali* përshkruhej si gota që kishte përdorur Krishti në darkën e fundit dhe që më pas kishte mbajtur gjakun e tij, por në ndryshim nga fjalori, në film, në një skenë të fundit zbulohet se *Graali* - gotë, nuk ishte prej smeraldi (siç e cilësonte fjalori!) dhe madje as prej floriri, por thjesht prej druri. Në fund të fundit Krishti kishte qenë vetëm një marangoz i varfër!

Shpjegimet e fjalorit na lanë të ftohtë dhe sikur na zbehën pak entuziazmin mbi filmin e Spielbergut. Papritmas ai na ngjau si një version hollivudian i atyre filmave që prodhohin pa u lodhur regjisorët e realizmit socialist të cilët gëlonin nga nazistët e këqij dhe të egër (në rolin e personazheve negative) që së fundmi kokulur detyroheshin të pranonin humbjen e turpshme përpara mirësisë dhe trimërisë së antinazistëve (Në rolin e personazheve pozitive). Ah, sikur të ishte kaq e lehtë të dalloje të mirën nga e keqja në jetën e përditshme!

I rritur në një regjim diktatorial komunist e dija se edhe diktatura naziste ashtu si edhe ajo komuniste që në fillimet e saj e kishte konsideruar krishterimin sa edhe simbolet e tij si një konkurrent të rrezikshëm në luftën për zotërimin dhe ruajtjen e pushtetit absolut. Një konkurrent me të cilin herët a vonë do i duhej të përballej. Atëherë vallë cili ishte shkaku që i kishte shtyrë nazistët të përfshiheshin në kërkimin e *Graalit* (gotën e Krishtit), simbol i një feje për të cilën jo vetëm nuk kishin asnjë simpati por madje edhe e urrenin për shkak të lidhjeve të shumta që ajo kishte me kulturën hebraike?

I dhamë fund arsytimit tonë, se filmi ishte thjesht krijesë e fantazisë pjellore të Spielbergut dhe asgjë më tepër. Por duket se kjo përgjigje nuk mjaftoi për të shuar tek unë një herë e përgjithnjë dëshirën për të zbuluar identitetin e *Graalit* sa edhe misterin dhe historinë që ai mbartte. Disa vite më pas (përsëri padashur!), rinisa udhëtimin tim (këtë herë i vetëm!), në kërkim të *Graalit* dhe fillova të koleksionoj në bibliotekën time, pa asnjë qëllim të caktuar të gjithë librat, që në një mënyrë apo një tjetër flisnin për të. Shkaktar ndoshta u bë një libër xhepi (nga ata që blihen nëpër stacionet e trenave për të shtyrë kohën gjatë udhëtimit!) në të cilin flitej shkarazi për një studiues gjerman i quajtur Otto Rahn, i cili e kishte kaluar gjithë jetën e tij në kërkim të *Graalit* dhe e kishte humbur atë, ndoshta për shkak të tij. Dhe Otto Rahn nuk qe një gjerman i zakonshëm por një oficer i vërtetë i reparteve famëkeqe SS. Ky informacion më risolli në kujtesë filmin e Spielbergut dhe interesin që dikur ai më kishte ngjallur mbi *Graalin*.

Atëherë ishte e vërtetë që nazistët e kishin kërkuar *Graalin*!

A e kishte ditur këtë, regjisori amerikan kur kishte filmuar "Indiana Jones"? Çfarë i kishte shtyrë nazistët të viheshin në kërkim të *Graalit*?

Kush ishte ky, "Indiana Jones" nazist, i quajtur Otto Rahn?



II

OTTO RAHNI DHE "KRYQËZATA KUNDËR GRAALIT"

Otto Rahni lindi në vitin 1904. Si të gjithë fëmijët gjermanë të brezit të tij ishte rritur me kujtimin e entuziazmit të një luftime në të cilën Gjermania do të dilte fitimtare dhe të një adoleshence të rrënuar nga zhgënjimi dhe pasojat e tmerrshme që solli për gjermanët humbja e luftës. Gjendja e mirë ekonomike e familjes i dha mundësi Ottos të arsimohej në fushën e filologjisë klasike dhe nga ana tjetër pasioni për historinë, mitet antike dhe legjendat mesjetare e ndihmuan t'i shmangej realitetit dhe të jetonte mes rrëfenjave fantastike të një bote të shkuar në të cilën adoleshenti Otto do të ëndërronte një rrugë shpëtimi për atdheun e tij të përkulur dhe të zhgënjyer!

Ishte një ide sa e çmendur aq edhe e pamundur, por në fund të fundit, në 10 vjetët që ndoqën Gjermaninë e pasluftës askujt nuk i kishte ardhur ndonjë ide tjetër më e mirë se ajo e Ottos për të shpëtuar vendin nga rrënimi.

Gjermania nuk ka më shpresa! është mallkuar nga zoti! Qaheshin gjermanët e sflitur nga kriza ekonomike që dukej sikur nuk do t'i vinte kurrë fundi.

Vetëm një Mrekulli!

Po...

Po, vetëm një mrekulli mund ta shpëtonte Gjermaninë dhe Otto, ëndërrimtari i heshtur i historisë së shkruar dhe të pashkruar vendosi të vihej në kërkim të mrekullisë së quajtur *Graal*. Ndër librat më të preferuar të Ottos ishin moria e romaneve mesjetare që rrëfenin aventurat e kalorësve të mbretit Artur në kërkim të *Graalit* dhe mes tyre më e dashura për të ishte ajo e shkruar nga shkrimtari mesjetar Wolfram von Eschenbah me titullin "Parsifal". Nga e njëjta vepër ishte frymëzuar edhe kompozitori gjerman Rikard Wagner për të krijuar operën e tij më të famshme. Dhe kishte qenë pikërisht "Parsifali" i Wagnerit, e cila kishte ndezur pasionin e shumë bashkëmohatarëve të Ottos për historitë e *Graalit*. Por Otto nuk ishte si gjithë të tjerët. Ishte i bindur se historia e *Graalit* nuk ishte thjesht një krijim i bukur i fantazisë njerëzore por një e vërtetë historike që për një shkak apo një tjetër ishte shndërruar në një legjendë. Për shumë vite e kërkoi këtë të vërtetë të fshehur mes rreshtave të Parsivalit të Wolfram von Eschenbah dhe së fundmi i ngjau se kishte rënë në



gjurmët e saj. Ah! Nëse ato gjurmë të fshira nga koha ishin të vërteta dhe jo thjesht një pjellë e fantazisë së tij, ato do ta çonin drejt e te *Graali* i cili do ta shpëtonte Gjermaninë e tij në një mënyrë apo në një tjetër. I nxitur nga këto shpresa të marra (të marra?!), shiti gjithçka që i kishte ngjelur nga trashëgimia e vogël që i kishin lënë prindërit dhe pa e bërë të gjatë u nis në kërkim të *Graalit*. Një udhëtim nga i cili nuk do të kthehej kurrë më...

Viti 1931 e gjeti në krahinën franceze të Lingudokës në këmbët e Pirenejve ku në qytetin turistik Ussat les Bains ndeshi në një muze privat të pajisur me një bibliotekë që në koleksionin e saj ruante thujse gjithçka që fliste mbi herezinë e vjetër të albigezëve të quajtur ndryshe edhe katar. Ishte ajo që kërkonte!

Ajo që kërkonte?

Çfarë i lidhte katarët apo albigezët me *Graalin*?

Në pamje të parë asgjë, por për Otton në historinë e herezisë së tyre të mbytur në gjak nga kisha e Romës fshiheshin gjurmët e fundit që *Graali* kishte lënë në kujtesën njerëzore. Në të vërtetë informacioni që kemi sot mbi herezinë e albigezëve edhe pse mbi ta janë shkruar një pafundësi librash është shumë i pakët dhe kryesisht vjen nga dosjet e inkuizionit. Ngjan se albigezët besonin në ekzistencën e dy zotave apo qenieve të përjetshme. Një luftë e përjetshme zhvillohej në univers midis principit të së mirës dhe atij të së keqes. Ajo që dukej se i bënte albigezët akoma më të frikshëm në sytë e kishës së Romës ishte bindja e këtyre se bibla dhe sidomos testamenti i vjetër i hebrenjve ishte mbarsur nga mendja djallëzore e zotit të së keqes, apo ndryshe e atij që hebrenjtë dhe më pas të krishterët e quanin Jehovah por edhe se mesazhet që zoti i së mirës i kishte dërguar njerëzimit me të dërguarit e tij si Krishti ishin keqinterpretuar me qëllim nga kisha e Romës, e cila ishte kthyer në shekuj në një vegël e zotit të së keqes. Nëse këto bindje të albigezëve ishin të vërteta mjaftonin plotësisht që kisha e Romës të vendoste pa mëdyshje të zhdukte nga rrënjët herezinë e tyre. Hapin e parë kisha e kishte hedhur në vitin 1145 kur pat dërguar për të luftuar herezinë teoricienin më të madh të doktrinës së krishterë të-kohës, që më vonë do të njihet me emrin e Shën Bernardit. Por murgu filozof Bernardi, pas udhëtimit në jug të Francës, ndërkohë që nuk do të arrinte asnjë rezultat të dukshëm në konvertimin e heretikëve, çuditërisht thujse me simpati do të pohonte se "*asnjë predikim nuk mund të jetë më i krishterë se ai i tyre (albigezëve) dhe morali i tyre (albigezëve) është i panjollë*". Fjalët e Shën Bernardit të shtyjnë të mendosh se jo të gjitha akuzat e tmerrshme që kisha e Romës i kishte bërë në kohë albigezëve ishin të vërteta. Por fjalët e Shën Bernardit nuk e bënë aspak kishën e Romës të hiqte dorë nga qëllimi i saj dhe e drejta që i kishte dhënë vetë zoti "për të çrrënjësuar dhe zhdukur" herezinë siç do të shprehej papa Inocenti III gjatë ceremonisë së kurorëzimit të tij në vitin 1198.



Ndërkohë që misionarët e kishës përshkonin jugun e Francës për të bindur fisnikët të mos vazhdonin të mbronin më brenda mureve të qyteteve të tyre albigezët, Papa ishte në pritje të një shkakui i cili të mund të justifikonte thirrjen e kryqëzatës, e cila ndryshe nga kryqëzatat e tjera nuk do të ndërmerrej kundër të pafeve myslimanë që kërcënonin Evropën dhe besimin te Krishti, por kundër të krishterëve, që ishin fajtorë vetëm sepse guxonin të besonin në Krishtin, në mënyrë disi të ndryshme, nga mënyra zyrtare e kishës së Romës. Dhe politikanët e kishës nuk vonuan shumë për t'i dhuruar Papës shkakun i cili do të justifikonte thirrjen e kryqëzatës kundër albigezëve!

Në 14 janar 1208 i dërguari i plotfuqishëm i Kishës së Romës në Linguadoka vritet në mënyrë të mistershme. Pa humbur kohë Papa Inocenti III akuzon për vrasjen e tij albigezët paqësorë, duke shpallur edhe thirrjen e kryqëzatës kundër tyre. Në 1209 një ushtri e përbërë nga më shumë se 30 000 kryqtarë vërshoi në Linguadoka. Viktima e parë e kryqtarëve u bë qyteti Beziers. Pas pushtimit të qytetit nga ushtritë kryqtare, më shumë se 15 000 qytetarë të Beziersit masakrohën pa mëshirë dhe midis këtyre fatkeqëve gjendeshin edhe rreth 7000 besimtarë katolikë të cilët shpresuan më kot të gjenin mbrojtje brenda mureve të kishës së Shën Madalenës. Por shenjtëria e Madalenës nuk mundi t'ua shpëtojë jetën. Shkallet, muret dhe kolonat e kishës së shenjtë u përskuqën nga gjaku i këtyre njerëzve të pafajshëm. Pas 20 vjet betejash dhe masakrash të përgjakshme që kryqtarët kryen pa u ndalur, të gjitha qytetet kryesore të jugut të Francës ranë në duart e kryqtarëve. Por kryqëzata nuk kishte marrë fund!

Vendin e ushtrisë së kryqtarëve e zuri një tjetër akoma më e tmerrshme. Ajo e inkuizitorëve të kishës së shenjtë. Shpjegimi zyrtar ishte kërkimi i besimtarëve albigezë të fshehur. Shpejt rrugët e qyteteve që i mbijetuan shkatërrimit të kryqtarëve u përflakën nga turrat e druve në të cilat digjeshin heretikët apo ata që hetuesit e inkuizicionit dyshonin se ishin të tillë. Dënimeve nuk i shpëtonin as emrat e të vdekurve që gjatë hetimeve vërtetoheshin se kishin qenë adhurues të herezisë së tmerrshme... Kufomat e tyre nxirreshin nga varret dhe digjeshin së bashku me të gjallët. Po a ishte ky qëllimi i vërtetë i hetimeve skrupuloze të njerëzve të errët të inkuizicionit? Tashmë që herezia e albigezëve nuk kishte më asnjë shpresë që të ringjallej, përse gjithë ky mund për ta çrrënjosur atë edhe nga varret e të vdekurve? Mos ndoshta diçka tjetër fshihej pas këtyre hetimeve?

Do të pëshpëritej se inkuizicioni në të vërtetë kërkonte gjurmët e një thesari të mrekullueshëm që albigezët kishin fshehur. Por a ekzistonte ky thesar?

Nëse vërtet ekzistonte, çfarë fshihte ky thesar i mrekullueshëm?

Otto Rahn ishte i bindur se kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjeshe me një fjalë të vetme...